

VENDIM
Nr.599, datë 18.3.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT, PËR DHËNIEN ME QIRA,
ME ÇMIMIN SIMBOLIK 1 (NJË) EURO, TË SHOQËRISË “BERATEKS” SHA BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, të mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien me qira, me procedurë 1 (një) euro/kontrata, të shoqërisë “Berateks” sh.a., Berat, për zhvillimin e një veprimtarie ekonomike.
 2. Kriteret për dhënien me qira të kësaj shoqërie të jenë:
 - a) Investimi 50 pikë;
 - b) Punësimi 30 pikë;
 - c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.
 3. Për dhënien me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në vendimin nr.1712, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira ose enfiletozë të pasurive shtetërore”.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha